

UDHËZIM
Nr. 5, datë 3.3.2021

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 30.3.2020, “PËR
PËRCAKTIMIN E ELEMENTEVE PËRBËRËSE, FORMËN E DIPLOMËS OSE
CERTIFIKATËS SË LËSHUAR NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË DHE
PROCEDURËS SË REGJISTRIMIT TË TYRE NË REGJISTRIN SHTETËROR TË
DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE PËR ARSIMIN E LARTË DHE KËRKIMIN
SHKENCOR”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 10 dhe 91, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 10, datë 30.3.2020, bëhen këto ndryshime:

a) Shkronja “m”, e pikës 1, të kreut II, riformulohet si vijon:

“m) Numri i matrikullimit të ciklit paraardhës të studimeve në diplomat e ciklit të dytë dhe të tretë/numri i regjistrimit që gjendet në vërtetimin e njësimin të diplomës, për diplomat që janë lëshuar jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe ID e Maturës Shtetërore/numri i dokumentit të njëvlershmërisë së dëftesës/diplomës së arsimit të mesëm të lartë që është lëshuar jashtë Republikës së Shqipërisë (numri i regjistrimit të veçantë për studentët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë para vitit 2006) në diplomat “Bachelor”, diplomat ose certifikatat profesionale dhe diplomat “Master i shkencave” të programeve të integruara të studimeve;”.

b) Shkronja “n”, e pikës 1, të kreut II, riformulohet si vijon:

“n) Numri i diplomës së studimeve universitare të përfunduara më parë për diplomat e ciklit të dytë dhe të tretë/Numri i regjistrimit që gjendet në vërtetimin e njësimin të diplomës;”.

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Evis Kushi**